



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 189

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E premte, 8 nëntor 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 365, datë 5.11.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 20891
Dekret i Presidentit nr. 366, datë 5.11.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 20891
Dekret i Presidentit nr. 367, datë 5.11.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 20891
Dekret i Presidentit nr. 368, datë 5.11.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 20891
Dekret i Presidentit nr. 369, datë 5.11.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 20892
Dekret i Presidentit nr. 370, datë 5.11.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 20892
Dekret i Presidentit nr. 371, datë 5.11.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 20892
Dekret i Presidentit nr. 372, datë 5.11.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 20893
Dekret i Presidentit nr. 373, datë 5.11.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 20893
Dekret i Presidentit nr. 374, datë 5.11.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 20893
Dekret i Presidentit nr. 375, datë 5.11.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 20894
Dekret i Presidentit nr. 376, datë 5.11.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 20894

Dekret i Presidentit nr. 377, datë 5.11.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	20894
Dekret i Presidentit nr. 379, datë 5.11.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	20895
Dekret i Presidentit nr. 381, datë 5.11.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	20895
Dekret i Presidentit nr. 382, datë 5.11.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	20895
Dekret i Presidentit nr. 383, datë 5.11.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	20895
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 684, datë 6.11.2024	Për krijimin e shoqërisë aksionare “Enti Kombëtar i Operimit Rrugor” sh.a.....	20896
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 685, datë 6.11.2024	Për disa shtesa në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar.....	20897
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 6.11.2024	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rikonstrukcion rruge, fshati Drenovicë”, Bashkia Dimal.....	20899
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 6.11.2024	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave publike, qyteti Përmet”	20901
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 688, datë 6.11.2024	Për disa ndryshime në vendimin nr. 17, datë 13.1.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e afateve të përdorimit të armëve, të teknikës e të pajisjeve të Forcave të Armatosura dhe të rregullave për trajtimin e tyre pas heqjes nga armatimi dhe përdorimi”, të ndryshuar	20902
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 689, datë 6.11.2024	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2024, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.....	20907
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 21, datë 22.10.2024	Për përcaktimin e procedurës së përzgjedhjes së arsimtarëve të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë, autorizimit dhe lidhjes së kontratës individuale me arsimtarin dhe të monitorimit të mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë”	20907
Udhëzim i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 888, datë 29.10.2024	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 33, datë 20.12.2023, “Për mënyrën e zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 161, datë 21.3.2018, ‘Për pagesën e së ardhurës nga papunësia’”, i ndryshuar.....	20909
Urdhër i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 846, datë 11.10.2024	Për përfaqësimin në mungesë të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme.....	20909
Urdhër i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 897, datë 22.10.2024	Për caktimin e fushës së përgjegjësisë dhe delegimit të kompetencave të zëvendësministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme.....	20910

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 912, datë 4.11.2024	Për delegim të përkohshëm kompetencash.....	20910
Urdhër i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 922, datë 28.10.2024	Për caktimin e fushës së përgjegjësisë dhe delegimit të kompetencave të zëvendësministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme.....	20911
Urdhër i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 923, datë 28.10.2024	Për caktimin e fushës së përgjegjësisë dhe delegimit të kompetencave të zëvendësministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme.....	20911
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 67, datë 3.10.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 8223, datë 29.9.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 185, datë 5.2.2010, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2011-277, datë 25.3.2011, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.	20912

**DEKRET****Nr. 365, datë 5.11.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetasve:

1. Sultan Kemal Aruçi (Altindeğer)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 366, datë 5.11.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Bekim Azem Hertica
2. Denisa Zija Krasniqi (Rifatoska)
3. Sofë Kujtim Çuni (Dula)
4. Nazif Shyqyri Gashi
5. Alberina Ali Molla (Sokoli)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 367, datë 5.11.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Emin Habib Özyol
2. Vural Ali Saridağ

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 368, datë 5.11.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,



DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Genc Bujar Tresi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 369, datë 5.11.2024

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:

1. Seval Süleyman Alkaya (Gümüş)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 370, datë 5.11.2024

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Ali Agim Vlahna

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 371, datë 5.11.2024

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:

1. Anisa Adriatik Kapaj



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 372, datë 5.11.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasit:

1. Frederik Anton Çuperjani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 373, datë 5.11.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Peter Benedict Paul James Thompson

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 374, datë 5.11.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasit:

1. Erlin Hysen Nina

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj



DEKRET
Nr. 375, datë 5.11.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Rudin Agron Gjataj
2. Thoma Kristo Roça
3. Florian Remzi Islamaj
4. Lajz Stefan Çapaliku
5. Filomena Mark Maka
6. Tonine Filip Andracchio (Ndrekaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 376, datë 5.11.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

Faqe | 20894

1. Sandër Dashnor Xërxa
2. Elvisa Beqë Rexha
3. Eminent Mon Krasniqi
4. Kada Fetah Çollaku (Karakushi)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 377, datë 5.11.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Visar Agron Bunjaku
2. Selvije Hazer Rudaj (Xhoxhaj)
3. Afrim Aziz Krasniqi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**DEKRET****Nr. 379, datë 5.11.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Labinot Xhevat Lala
2. Alemsha Ismet Jashari (Hoxhaj)
3. Nehal Ismet Lisica (Hoxhaj)
4. Xhemali Ismet Hoxha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 381, datë 5.11.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Antonio Rocco De Paola

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 382, datë 5.11.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

I lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Denisa Durim Pengu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 383, datë 5.11.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,



DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Lorena Bashkim Simoni (Salla)
2. Diana Enver Zeneli (Pasho)
3. Nikol Ilir Hoxha
4. Endi Shkëlqim Spaho
5. Anna Alban Parllaku

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 684, datë 6.11.2024

**PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË
AKSIONARE “ENTI KOMBËTAR I
OPERIMIT RRUGOR” SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 105, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e shoqërisë aksionare, me kapital 100 (njëqind) % shtetëror, me emërtimin “Enti Kombëtar i Operimit Rrugor”, në vijim “EKORR sh.a.”, me qëllim ofrimin e shërbimit të operimit për mundësimin e aksesit në rrugë të përdoruesve.

2. EKORR sh.a. ofron kundrejt pagesës shërbimin e operimit dhe çdo shërbim tjetër, në përputhje me qëllimin e krijimit dhe statutin e saj.

3. Shoqëria aksionare, sipas përcaktimeve në pikën 1 të këtij vendimi, themelohet, organizohet dhe funksionon me dy nivele administrimi, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9901, datë

14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

4. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë përfaqëson shtetin si pronar të 100 (njëqind) % të aksioneve të shoqërisë dhe brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi ndjek procedurat e nevojshme ligjore, për:

a) themelimin dhe miratimin e statutit të shoqërisë aksionare;

b) regjistrimin e shoqërisë aksionare në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

5. Kapitali fillestar për krijimin e shoqërisë aksionare të jetë 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë. Vlera prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh transferohet nga buxheti i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, pranë shoqërisë EKORR sh.a., menjëherë pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

6. Organet drejtuese të shoqërisë aksionare EKORR sh.a., sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, janë Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit, Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori. Detyrat dhe përgjegjësitë e Asamblesë së Përgjithshme, të Këshillit Mbikëqyrës e të Administratorit, si dhe organizimi e funksionimi i shoqërisë janë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, të ndryshuar, dhe parashikimeve në statutin e EKORR sh.a.

7. EKORR sh.a. ka si objekt të veprimtarisë:

a) operimin e rrugëve me pagesë;

b) mirëmbajtjen e infrastrukturës së operimit, e cila përfshin sistemin e portave të automatizuara për lejimin e hyrje-daljeve në rrugë, sistemin elektronik për mbledhjen e tarifave dhe serverat e nevojshëm për mbajtjen e përpunimin e të dhënave dhe të arkëtimeve përkatëse;

c) prodhimin dhe shpërndarjen e biletave të pajtimit mujor (aboneve) për përdoruesit e rrugëve me pagesë;

ç) arkëtimin e tarifës në rrugët me pagesë;

d) monitorimin dhe koordinimin e shërbimit të operimit në rrugët me pagesë, operimi i të cilave kryhet nga shoqëritë koncesionare përkatëse;

dh) sigurimin e sistemeve dhe aplikacioneve elektronike për menaxhimin dhe përdorimin e portave të automatizuara për lejimin e hyrje-daljeve në rrugë, për mbledhjen e tarifave dhe serverave të nevojshëm për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave e të arkëtimeve përkatëse.



8. Veprimtaritë e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 7, të këtij vendimi, kryhen nga EKORR sh.a., përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe në kontratat përkatëse të koncesionit.

9. Për rrugët me pagesë, të cilat nuk janë në kontrata koncesioni dhe mirëmbahen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, EKORR sh.a. lidh marrëveshje të veçantë me Autoritetin Rrugor Shqiptar për kryerjen e veprimtarive të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 7, të këtij vendimi. Në marrëveshjen e veçantë, ndër të tjera, parashikohen dispozita për arkëtimin e tarifës dhe të ardhurave të tjera nga operimi i rrugës, si dhe për tarifën që EKORR sh.a., përfiton për kryerjen e veprimtarive përkatëse.

10. EKORR sh.a. mund të ofrojë shërbime të tjera shtesë për subjekte publike dhe private, në përputhje me qëllimin e krijimit, fushën e veprimtarisë dhe statutin e saj.

11. Shoqëria aksionare financohet nga të ardhurat e veta nga ofrimi i shërbimeve dhe burime të tjera të ligjshme. Të ardhurat e shoqërisë aksionare përdoren për ushtrimin e veprimtarisë së saj.

12. Burimi i të ardhurave të EKORR sh.a., janë:

a) të ardhurat nga tarifa vjetore që përfitohet nga shoqëritë koncesionare që kryejnë shërbimin e operimit në rrugët kombëtare me pagesë, sipas përcaktimeve në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) të ardhurat nga tarifa që përfitohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar për kryerjen e veprimtarive të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 7, të këtij vendimi, në bazë të marrëveshjes përkatëse;

c) të ardhurat nga arkëtimi i tarifës në rrugët me pagesë;

ç) të ardhura të tjera të ligjshme të cilat vijnë nga kryerja e veprimtarive sipas pikës 7, të këtij vendimi;

d) të ardhura të tjera të lejuara, si: grantet dhe huat.

13. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë i siguron shoqërisë aksionare mjediset e punës, të nevojshme për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë.

14. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi për krijimin e kapitalit fillestar të shoqërisë, në vlerën 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për vitin 2024, në programin “Transporti rrugor”.

15. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCË 1
TARIFA E SHËRBIMIT TË ENTIT
KOMBËTAR TË OPERIMIT RRUGOR SHA

1. Tarifa vjetore e shërbimit të EKORR sh.a., përcaktohet si herësi i mesatares gjeometrike të kostove të operimit* e shprehur në % (përqindje) me vlerën e të ardhurave për secilin vit, si më poshtë:

* mesatare gjeometrike e kostove të operimit
(%)= $\sqrt[n]{a_1 a_2 \cdots a_n}$

a = b/c (raporti midis kosos së operimit me vlerën e të ardhurave të parashikuara për atë vit operimi e shprehur në %)

b = kosto operimi në atë vit

c = vlera e parashikuar e të ardhurave në atë vit

n = numri i viteve të operimit

VENDIM
Nr. 685, datë 6.11.2024

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.
408, DATË 13.5.2015, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
RREGULLORES SË ZHVILLIMIT TË
TERRITORIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullores së zhvillimit të territorit, bashkëlidhur vendimit nr. 408, datë 13.5.2015, të



Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Pas pikës 3, të nenit 6, shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Ndërtimi i çative të pashfrytëzueshme në zonat rurale, duke respektuar standardet teknike të miratuara nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit.”.

Neni 2

Nënndarja “vi”, e pikës 2.2, të nenit 6/1, shfuqizohet.

Neni 3

Në nënndarjen “xi”, të pikës 3, të nenit 7, pas fjalëve “... ndërtimi i çative të pashfrytëzueshme ...” shtohen “... në zonat urbane ...”.

Neni 4

Pas pikës 4, të nenit 9/1, shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

“5. Për lejet e zhvillimit që miratohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, në rastet e aksesit në tokat në pronësi të shtetit, që nuk janë të zëna me objekt dhe që nuk janë në administrim të institucioneve shtetërore, si dhe të patransferuara te njësitë e vetëqeverisjes vendore, leja e zhvillimit përmban edhe aksesin në këto prona, me përjashtim të pronave shtet për llojin e resursit “arë”, “ullishtë”, “pyll” dhe “kullotë”, pa pasur nevojë për një miratim nga pronari shtet.”.

Neni 5

Pas pikës 2, të nenit 13, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Nëse ndryshon pronësia e shumicës së pjesëve/aksioneve të shoqërisë tregtare, në favor të së cilës është lëshuar leje ndërtimi, subjekti zhvillues njofton nëpërmjet sistemit *e-Leje* autoritetin e zhvillimit të territorit që ka miratuar lejen. Për lejet në kompetencë të Këshillit Kombëtar të Territorit, njoftimi i drejtohet sekretariatit të KKT-së. Për efekt njohës, autoriteti përkatës i bën me dije subjektit

zhvillues, nëpërmjet sistemit *e-Leje* konfirmimin për vijimin e punimeve.”.

Neni 6

Pas pikës 5, të nenit 19, shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:

“6. Në rastet e aksesit në tokat në pronësi të shtetit, që nuk janë të zëna me objekt dhe që nuk janë në administrim të institucioneve shtetërore, si dhe të patransferuara te njësitë e vetëqeverisjes vendore, leja e ndërtimit përmban edhe aksesin në këto prona, me përjashtim të pronave shtet për llojin e resursit “arë”, “ullishtë”, “pyll” dhe “kullotë”, pa pasur nevojë për një miratim nga pronari shtet.”.

Neni 7

Pas nenit 27/2 shtohet neni 27/3, me këtë përmbajtje:

“Neni 27/3

Në rastet e parashikuara në pikën 2/1, të nenit 13, të kësaj rregulloreje, kur subjekti zhvillues nuk ka paraqitur më parë kërkesën për njoftim sipas përcaktimeve të kësaj dispozite, autoriteti përgjegjës i zhvillimit të territorit ka të drejtë të refuzojë lëshimin e certifikatës së përdorimit.”.

Neni 8

Dispozitë kalimtare

1. Detyrimet sipas neneve 5 dhe 7, të këtij vendimi, zbatohen vetëm për lejet e ndërtimit që do të miratohen pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Agjencia e Zhvillimit të Territorit merr të gjitha masat për të parashikuar aksesin në pronë për lejet e zhvillimit dhe ndërtimit, sipas neneve 4 dhe 6, të këtij vendimi, për të gjitha vendimmarrjet e Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, që konfirmohen pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit për miratimin e standardeve teknike të nevojshme për ndërtimin e çative të pashfrytëzueshme brenda 1 (një) muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.



Neni 9
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 686, datë 6.11.2024

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË
PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“RIKONSTRUKSION RRUGE, FSHATI
DRENOVICË”, BASHKIA DIMAL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rikonstruksion rruge, fshati Drenovicë”, Bashkia Dimal.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Dimal.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, kompensohet në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 1 750 494 (një milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 1 750 494 (një milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër) lekësh përballohet nga buxheti i Bashkisë Dimal.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Dimal.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Dimal.

8. Bashkia Dimal kryen procedurat për likuidimin e pronarit të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Dimal.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Dimal për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Dimal për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Dimal, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



LISTA EMËRORE E PRONARIT, TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHET PËR INTERES PUBLIK PËR
REALIZIMIN E PROJEKTTT “RIKONSTRUKSION RRUGE, FSHATI DRENOVICË”, BASHKIA DIMAL

Nr.	Pronari			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)									TRUALL			NDËRTESE			VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME (kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
1	Xhezmi	Ali	Sulovari	Kutalli	2349	45/7	Truall	84	84	84	8	44	84	203	17,052	84		1,733,442	1,750,494	Konfirmuar nga ASHK-ja
VLERA TOTALE															17,052			1,733,442	1,750,494	



VENDIM
Nr. 687, datë 6.11.2024

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “ZGJERIMI I VARREZAVE
PUBLIKE, QYTETI PËRMET”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave publike, qyteti Përmet”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Përmet.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 940 800 (nëntëqind e dyzet mijë e tetëqind) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 940 800 (nëntëqind e dyzet mijë e tetëqind) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Përmet.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Përmet.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i

përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Përmet.

8. Bashkia Përmet kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Përmet.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Përmet, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Përmet për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Përmet për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Përmet, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Përmet, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Gjirokastrë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



LISTA EMËRORE E PRONARËVE, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK PËR REALIZIMIN E PROJEKTTI “ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE QYTETI PËRMET”

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)							VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM				SHËNIM E (KUFIZIME HIPOTEKORE, BARRE MBI PASURINË etj.)
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. Kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	VLERA TOTALE (lekë)	
1	GEZIM	MEHDI	IBRAHIMI	Përmet	1589	26/2	arë	4000	2	9	3,490	112	390,880	390,880	Konfirmuar nga ASHK-ja Bashkëpronësi 1/5 e pasurisë
	KAPLLAN	MEHDI	IBRAHIMI												
	ABAZ	MEHDI	IBRAHIMI												
	ZEGJAVETE	MEHDI	IBRAHIMI												
	BAHRIE	MEHDI	IBRAHIMI												
2	DRITE	ISMAIL	IBRAHIMI	Përmet	1589	26/10	arë	2860	2	240	2,854	112	319,648	319,648	Konfirmuar nga ASHK-ja Bashkëpronësi 1/8 e pasurisë
	ILIRJAN	SOTIR	IBRAHIMI												
	ANDREA	SYRJA	RANGA												
	ANILA	KRISTUL	DHIMITRI												
	MARIA	SOTIR	NIKOLLA												
	MERJEME	SYRJA	MARKU												
	ROBERT	SYRJA	IBRAHIMI												
VALENTINA	SYRJA	JACE													
3	MITORE	IBRAHIM	MEMISHAJ	Përmet	1589	26/12	arë	2854	2	242	2,056	112	230,272	230,272	Konfirmuar nga ASHK-ja Bashkëpronësi 1/21 e pasurisë
	ZUBIDIE	IBRAHIM	BEJTJA												
	GEZIM	HALIL	MANCELLARI												
	ERMIRA	HALIL	MUKA												
	SHPETIM	HALIL	MANCELLARI												
	SHIPRESA	HALIL	XHIKA												
	FATBARDHA	KAMBER	HOXHA												
	VLADIMIR	SABAUDIN	KARAFILI												
	BESNIK	SABAUDIN	KARAFILI												
	FATOS	SABAUDIN	KARAFILI												
	SHIPRESA	SABAUDIN	LICO												
	MIMOZA	KAMBER	MIDHA												
	LILJANA	KAMBER	SEFERI												
	PELLUMB	KAMBER	MANCELLARI												
	BARDHYL	KAMBER	MANCELLARI												
	SANIJE	GANI	KARAFILI												
	AGRON	RIFAT	KARAFILI												
	AGIM	RIFAT	KARAFILI												
	IBRAHIM	EQEREM	KARAFILI												
LORETA	EQEREM	KARAFILI													
PAQE	METE	KARAFILI													
VLERA TOTALE											8,400		940,800	940,800	

VENDIM
Nr. 688, datë 6.11.2024

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 17, DATË 13.1.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E AFATEVE TË PËRDORIMIT TË ARMËVE, TË TEKNIKËS E TË PAJISJEVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA DHE TË RREGULLAVE PËR TRAJTIMIN E TYRE PAS HEQJES NGA ARMATIMI DHE PËRDORIMI”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “d”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tabelat nr. 1 dhe nr. 2, bashkëlidhur vendimit nr. 17, datë 13.1.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e afateve të përdorimit të armëve, të teknikës e të pajisjeve të Forcave të Armatosura dhe të rregullave për trajtimin e tyre pas heqjes nga armatimi dhe përdorimi”, të ndryshuar, zëvendësohen me tabelat me të njëjtët numra, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



Tabela nr. 1

PËR MJETET DHE PAJISJET USHTARAKE

Nr.	EMËRTIMI	AFATI I PËRDORIMIT		
		Në vite	Në kilometra	Në orë pune (M/orë)
I.	MJETE TË BLINDUARA			
1	Transportues i blinduar me zinxhirë	30	-	750
2	Transportues i blinduar me goma	25	-	800
3	Tërheqës	30	-	750
4	Tanke	35	-	750
II.	MJETE DETARE/ANIJE			
1	Anije transporti e madhe	40	-	-
2	Minahedhëse e madhe (MHM)	40	-	-
3	Gjuajtës detar i madh (GJDM)	40	-	-
4	Gjuajtës detar i vogël (GJDV)	40	-	-
5	Katër silurues	40	-	-
6	Anije patrulluese e madhe (A.65 Foot)	40	-	-
7	Anije silurë kapëse	40	-	-
8	Kateri i radës	40	-	-
9	Rimorkiator	40	-	-
10	Cisternë	40	-	-
11	Dok lundrues	40	-	-
12	Motoskaf	25	-	-
13	Anije palombare	40	-	-
14	Motogomë	25	-	-
15	Motobarkë	25	-	-
16	Anije ARCH ANGEL	25	-	-
17	Anije patrullimi STAN-PATROL 40	40	-	-
18	Anije klasi 42 Food	40	-	-
19	Anije klasi 65 Food	40	-	-
20	Anije antindotje	25	-	-
III.	AVIONË DHE HELIKOPTERË			
1	Avion Uti-Mig-17 (stërvitje)	-	-	4200
2	II-28 (Bombardues) stërvitje	-	-	7200
3	Avion Mig-19	-	-	3600
4	Avion Jak	-	-	6000
5	Avion fotografimi AN-2	-	-	4800
6	Avion pa pilot TB2	35	-	-
7	Helikopter	35	-	-
IV.	MJETE TRANSPORTI			
1	Motoçikletë	9	45 000	-
2	Autoveturë komerciale	10	200 000	-
3	Autobus	17	300 000	-
4	Mikrobus	12	240 000	-
5	Autoambulancë komerciale	12	150 000	-
6	Autoveturë rikonicioni	14	220 000	-
7	Autoambulancë taktike	14	140 000	-
8	Kamionçinë	14	210 000	-
9	Kamion i lehtë	18	180 000	-
10	Kamion i mesëm	18	180 000	-
11	Kamion i rëndë	20	270 000	-
12	Rimorkio	20	160 000	-
13	Autobot i mesëm	20	200 000	-
14	Autobot i rëndë	18	180 000	-
15	Rimorkiator	22	220 000	-



16	Kamion vetëshkarkues	18	180 000	-
17	Vinç pirun	20	160 000	-
18	Autovinç	20	200 000	-
19	Buldozer i mesëm me goma	20	120 000	-
20	Buldozer i rëndë me goma	20	160 000	-
21	Buldozer me zinxhirë	20	-	6000
22	Ekskavatorë dhe mjete dhe ngarkuese	20	-	8000
23	Autozjarrfikëse	25	300 000	-
24	Kamion linjë prodhim buke	25	250 000	-
25	Borëpastruese	20	200 000	-
V.	PAJISJET FUSHORE			
1	Furrë mekanike fushore	17	-	1 000
2	Karro kuzhina	17	-	1 000
3	Dushe fushore	10	-	1 000
4	Lavanderi fushore	10	-	1 000
5	Gjenerator me benzinë	12	-	1 000
6	Gjenerator diezel deri 10 kw	15	-	2 500
7	Gjenerator diezel mbi 10 kw	15	-	5 000
8	Pajisje frigoriferike	15	-	120 000
9	Soba gatimi fushore	10	-	1 000
10	Pajisje për pastrimin e ujit	20	-	1 000
VI.	MAKINERI DHE PAJISJE TË MIRËMBAJTJES			
1	Makineri dhe pajisje metalprerëse, vënë në punë para 1990	33	-	-
2	Makineri dhe pajisje metalprerëse, vënë në punë pas 1990	20	-	-
3	Makineri e pajisje elektronike	17	-	-
4	Makineri dhe pajisje punim druri	18	-	-
5	Makineri dhe pajisje (kaldajat)	13	-	-
6	Pajisje e instrumente testuese	12	-	-
7	Makineri e pajisje teknologjike	6	-	-
8	Makineri e pajisje teknologjike elektrike (elektropompa, elektrovinç, elektromotor, elektrokompresor, elektrosaldatriçe etj.)	10	-	-
9	Makineri e pajisje teknologjike motorike (motopompa, motokompresor, motosaldatriçe, motoshara dore etj.)	10	-	-
VII.	SISTEME DHE PAJISJE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT			
a)	Pajisje të radiokomunikimit komercial			-
1	Radiostacion 1 w	8	-	-
2	Radiostacion 5 w	8	-	-
3	Radiostacion 20 w	15	-	-
4	Radiostacion 25 w	15	-	-
5	Repertitor (përsëritës) 25 w	15	-	-
6	Repertitor (përsëritës) 50 w	15	-	-
b)	Pajisje të radiokomunikimit taktik			
7	Radiostacion 5 w	12	-	-
8	Radiostacion 20 w	15	-	-
9	Radiostacion 50 w	20	-	-
10	Radiostacion 100 w	20	-	-
11	Radiostacion 150 w	20	-	-
12	Radiostacion 400 w	20	-	-
13	Ngarkues i çelësve të kriptimit	20	-	-
14	Pajisje gjenerim çelësash	20	-	-
15	Repertitor (përsëritës)	20	-	-
16	Hub taktik	15	-	-
c)	Pajisje të mjedisit të transmetimit			
17	Radiorele	12	-	-



ç)	Pajisje të komunikimit telefonik			
18	Central telefonik elektronik	12	-	-
19	Aparat telefonik automatik	10	-	-
20	Aparat telefonik satelitor	10	-	-
21	Aparat telefonik VoIP	10	-	-
22	Aparat telefonik celular FD	5	-	-
23	Aparat telefonik me kriptim	10	-	-
24	Aparat faks	7	-	-
d)	Pajisje të burimeve të ushqimit elektrik			
25	UPS lokal	4	-	-
26	UPS 1 -5 KVA	6	-	-
27	UPS 6 -10 KVA	10	-	-
28	UPS mbi 15 KVA	15	-	-
29	Inverter 1 - 5 KVA	6	-	-
30	Inverter mbi 5 KVA	10	-	-
31	Stabilizator tensioni deri 15 KVA	15	-	-
32	Stabilizator tensioni mbi 15 KVA	15	-	-
33	Radrizator	15	-	-
dh)	Pajisje të teknologjisë së informacionit			
34	Server	10	-	-
35	Router	10	-	-
36	Pajisje kriptimi	15	-	-
37	Firewall	10	-	-
38	Switch të ndryshëm	5	-	-
39	Switch i menaxhueshëm	10	-	-
40	Kompjuter desktop	6	-	-
41	Kompjuter laptop	6	-	-
42	Kompjuter Workstation	6	-	-
43	Kompjuter laptop taktik	10	-	-
44	Tablet taktik	10	-	-
45	Printrer lokal	6	-	-
46	Printer rrjeti	6	-	-
47	Fotokopje	6	-	-
48	Fotokopje shumë funksionalëshe	6	-	-
49	Skaner	8	-	-
50	Video projektor	8	-	-
51	Tablet i zakonshëm FD	3	-	-
52	Pajisje VTC	10	-	-
53	Pajisje për çmanjetizim të <i>hardwar-eve</i>	15	-	-
54	Pajisje për shkatërrim të <i>hardwar-eve</i>	15	-	-
55	Ekran/monitor mbi 42"	10	-	-
56	Rack deri 42U	25	-	-
57	NVR/DVR mbi 16 kanale (zbulimi)	6	-	-
e)	Pajisje të radiozbulimit			
58	Radiomarrës 0.001KHz deri 6GHz	20	-	-
59	Marrës spektri modular 0.001KHz deri 6GHz	20	-	-
60	DF receiver HF/VHF/UHF	20	-	-
61	Analizator spektri	25	-	-
62	Gjenerator sinjali	25	-	-
63	Oshiloskop	25	-	-
64	Regjistruer digjital	20	-	-
65	Antenë rrethore 0.5-18 GHz	25	-	-
66	Antenë fikse 80-1000MHz	20	-	-
67	Antenë gjithëdrejtimëshe	20	-	-
68	Antenë parabolike 0.9-2.4m	20	-	-
69	Ndarës sinjali VHF/UHF	10	-	-
70	Ndarës sinjali HF	10	-	-



VIII.	PAJISJE ZBULIMI			
1	Dron UAS PUMA RQ 20B	-	-	400
IX.	PAJISJE TË SHËNDETËSISË			
1	Kompjuter tomografie	10	-	-
2	ECHO	10	-	-
3	Aparat rëntgeni	15	-	-

Tabela nr. 2

PËR SISTEMET E ARTILERISË DHE ARMATIMIN

Nr.	EMËRTIMI	AFATI I PËRDORIMIT		
		Në vite	Sasia e qitjeve(me regjim zjarri teknik normal)	Në orë pune (M/orë)
1	Pistoleta	-	5 000	-
2	Pushkë snajper	-	7,000	-
3	Automatik	-	12 000	-
4	Mitraloz i lehtë	-	15 000	-
5	Mitraloz kompanie	-	10 000	-
6	Mitraloz i rëndë	-	10 000	-
7	Granatahedhëse e lehtë kundërtank (GHLKT)	-	1000	-
8	Mortajë 60 mm	-	5 000	-
9	Mortajë 82 mm	-	6 000	-
10	Mortajë 81 mm	-	6 000	-
11	Top 75 mm	-	5 000	-
12	Pistoleta shenjëdhënëse	-	5 000	-
13	Obus 122 mm	-	4 500	-
14	Top 122 mm	-	4 500	-
15	Top obus 152 mm	-	4 500	-
16	Mitraloz KA 12.7 mm	-	9 000	-
17	Top KA 37 mm	-	7 000	-
18	Raketë portative (shtrat lëshimi) 10	10	-	-
19	Top KA 57 mm	-	7 000	-
20	Shotgun 12	-	5000	-
21	Lëshues granate 40 mm x 46 NATO	-	1000	-
22	Mortaj 120mm NATO	-	8000	-
23	Top 20 mm	-	7500	-
24	Top 155 mm	-	4500	-
25	Raketa kundërtanke mbi 100 mm NATO	25 vjet	-	-
26	Raketa k/ajrore (V-Shoard)	25 vjet	-	-



VENDIM
Nr. 689, datë 6.11.2024

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2024, MIRATUAR
PËR KOMISIONIN QENDROR TË
ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2024, në programin 01610 “Planifikim, menaxhim, administrim”, i shtohet fondi prej 20 900 000 (njëzet milionë e nëntëqind mijë) lekësh, në zërin “Shpenzime korrente”, për mbulimin e shpenzimeve përgatitore, që i paraprijnë zgjedhjeve për Kuvendin, të vitit 2025.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2024.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 21, datë 22.10.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS
SË PËRZGJEDHJES SË ARSIMTARËVE
TË GJUHËS SHQIPE DHE TË
KULTURËS SHQIPTARE NË DIASPORË,
AUTORIZIMIT DHE LIDHJES SË
KONTRATËS INDIVIDUALE ME
ARSIMTARIN DHE TË MONITORIMIT
TË MËSIMDHËNIES SË GJUHËS
SHQIPE DHE TË KULTURËS
SHQIPTARE NË DIASPORË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 16/2018, datë 5.4.2018, “Për diasporën”, të ndryshuar; të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe vendimit nr. 443, datë 26.6.2019, të Këshilli të Ministrave, “Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë”, të ndryshuar,

UDHËZOJMË:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim përcakton procedurën e përzgjedhjes së arsimtarëve të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë, autorizimin dhe lidhjen e kontratës individuale me arsimtarin, si dhe të monitorimit e mësimitdhënies së gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë, në rastet kur ministria përgjegjëse për punët e jashtme dhe diasporën propozon organizimin e procesit mësimor në një vend, me të cilin nuk ka marrëveshje dypalëshe ndërkombëtare nga Republika e Shqipërisë.

KREU II
**PROCEDURA E PËRZGJEDHJES SË
ARSIMTARËVE TË GJUHËS SHQIPE DHE
TË KULTURËS SHQIPTARE NË DIASPORË**

1. Arsimtarët që japin mësimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë përzgjidhen sipas një procedure të hapur, transparente dhe gjithëpërfshirëse.



2. Hapja e thirrjes për arsimtarë për mësimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në shtetin e përcaktuar realizohet nga ministria përgjegjëse për punët e jashtme dhe diasporën.

3. Procesi i aplikimit zhvillohet dhe monitorohet përmes faqes zyrtare të hapur nga misioni diplomatik i shtetit të përcaktuar.

4. Thirrja përmban kriteret e nevojshme që kandidati duhet të plotësojë për të qenë arsimtar i gjuhës shqipe dhe i kulturës shqiptare në diasporë, dokumentet që duhet të dorëzojnë, si dhe afatet e aplikimit. Thirrja për aplikime është e përvitshme.

5. Kriteret dhe dokumentet që dorëzojnë kandidatët për arsimtarë përcaktohen bazuar në vendimin nr. 104, datë 28.2.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve për krijimin e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatës për nxënësit në diasporë”.

6. Me përfundimin e afateve të aplikimit, dokumentacioni i aplikimeve përcillet nga misioni diplomatik në Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë të Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për t’u vlerësuar.

7. Komisioni i ngritur në ASCAP bën vlerësimin e kandidaturave, duke u bazuar në vendimin nr. 104, datë 28.2.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve për krijimin e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatës për nxënësit në diasporë”.

8. Lista me vlerësimin e kandidaturave i përcillet ministrisë përgjegjëse për arsimin, e cila e përcjell te ministria përgjegjëse për punët e jashtme dhe diasporën.

9. Ministria përgjegjëse për punët e jashtme dhe diasporën, përmes misionit diplomatik të përfshirë në proces, duke u bazuar në nevojat për arsimtarë të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në shtetin ku do të zhvillohet mësimi dhe duke iu referuar listës së ASCAP-it, bën përzgjedhjen përfundimtare të arsimtarëve.

10. Arsimtarët e përzgjedhur zhvillojnë mësimin në gjuhën shqipe bazuar në kurrikulën e mësimit plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë, miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës, nr. prot. 3149/1, datë 8.5.2018, në Tiranë, dhe nr. prot. 2372/01B, datë 31.5.2018, në Prishtinë, si dhe në udhëzuesin për

zhvillimin e mësimi të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare, të përgatitur nga ASCAP-i.

KREU III PROCEDURA E LIDHJES SË KONTRATËS INDIVIDUALE ME ARSIMTARIN

1. Lidhja e kontratës individuale me arsimtarin në diasporë realizohet nga kreu i misionit diplomatik i akredituar në vendin ku ndodhet diaspora dhe ku është hapur thirrja. Thirrja për vitin shkollor 2024–2025 dhe në vijim bëhet për Greqinë. Përcaktimi i vendeve të tjera bëhet me miratimin me shkrim të ministrave.

2. Kontrata ndërmjet palëve do të rregullohet sipas parashikimeve të Kodit të Punës.

3. Pagesa e arsimtarit përllëgaritet bazuar në numrin e orëve mësimore mujore, të përcaktuara në kontratën e lidhur mes palëve, referuar pagës së punonjësit të personelit administrativo-teknik vendës në misionin diplomatik ku ndodhet diaspora.

KREU IV MONITORIMI I PROCESIT MËSIMOR

1. Monitorimi i procesit mësimor do të realizohet nga strukturat e misionit diplomatik të akredituar në vendin ku ndodhet diaspora.

2. Monitorimi i mësimi të gjuhës shqipe dhe i kulturës shqiptare në diasporë realizohet përmes vëzhgimeve, vlerësimit të dokumentacionit (plane mësimore dhe regjistra), si dhe pyetësorëve për nxënësit dhe për prindërit, të cilët realizohen *online* dhe në bashkëpunim me organizata jofitimprurëse vendëse, të cilat mbajnë kontakte me misionin diplomatik.

3. Misioni diplomatik bazuar në monitorimet mbi ecurinë e punës së arsimtarëve të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë, harton çdo vit mësimor një relacion përmbledhës të monitorimit dhe e paraqet atë në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme dhe diasporën dhe kjo e fundit ia përcjellë ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe sportin.



KREU V
DISPOZITAT KALIMTARE DHE
TË FUNDIT

1. Procedurat e ndjekura, dokumentet e administruara dhe vendimet e marra për zbatimin e këtij udhëzimi ruhen sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin për arkivat në Republikën e Shqipërisë dhe janë objekt monitorimi dhe inspektimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria për Arsimin dhe Sportin.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Ogerta Manastirliu

MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Igli Hasani

UDHËZIM
Nr. 888, datë 29.10.2024

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN
NR. 33, DATË 20.12.2023, “PËR
MËNYRËN E ZBATIMIT TË VENDIMIT
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.
161, DATË 21.3.2018, “PËR PAGESËN E SË
ARDHURËS NGA PAPUNËSIA”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 24, të vendimit nr. 161, datë 21.3.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për pagesën e së ardhurës nga papunësia”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 33, datë 20.12.2023, “Për mënyrën e zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 161, datë 21.3.2018, “Për pagesën e së ardhurës nga papunësia”, të ndryshuar, shkronja “a” e pikës 3, ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“a) Të gjithë personat, të cilët kanë kontribuar si punëmarrës në sigurimet shoqërore, për një

periudhë të paktën 12-mujore, për çdo rast përfitimi”.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS
DHE INOVACIONIT
Blendi Gonxhja

URDHËR
Nr. 846, datë 11.10.2024

**PËR PËRFAQËSIMIN NË MUNGESË TË
MINISTRIT PËR EVROPËN DHE
PUNËT E JASHTME**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; neneve 3, 5 dhe 11 të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; nenit 6, pika 2, të ligjit nr. 9000/2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; nenit 15, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Zëvendësministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme, znj. Megi Fino, të zëvendësojë në mungesë ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme.

2. Zëvendësimi të realizohet çdo herë që ministri është me shërbim jashtë vendit, në përputhje me dispozitat ligjore.

3. Të gjitha detyrat për drejtimin e ministrisë, zbatimin e programit të Këshillit të Ministrave, mbulimi i punës administrative dhe kontrolluese në institucion të ndiqen nga zëvendësministri.

4. Urdhri nr. 244, datë 15.4.2024, “Për përfaqësimin në mungesë të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Igli Hasani

**URDHËR****Nr. 897, datë 22.10.2024****PËR CAKTIMIN E FUSHËS SË
PËRGJEGJËSISË DHE DELEGIMIT TË
KOMPETENCAVE TË
ZËVENDËSMINISTRIT PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 22, 28, 29 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neneve 3, 5 dhe pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000/2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; nenit 15, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 81/2022, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”,

URDHËROJ:

1. Znj. Megi Fino, zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, gjatë ushtrimit të detyrës të ndjekë dhe të përgjigjet para ministrit për çështjet e mëposhtme:

a) ndjekjen, koordinimin, monitorimin dhe raportimin mbi ecurinë e zbatimit të angazhimeve në kuadrin e procesit të integritetit evropian;

b) përgatitjen e raporteve për Kuvendin, Këshillin e Ministrave dhe institucionet e Bashkimit Evropian, në lidhje me procesin e integritetit evropian.

2. Zëvendësministri, përveç detyrave të përmendura në këtë urdhër, ndjek çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga ministri.

3. Zëvendësministri bashkëpunon dhe koordinon me zëvendësministrat e tjerë për çështje të caktuara, që ndërlikohen në fushën e përgjegjësisë së 2 (dy) ose më shumë zëvendësministrave.

4. Ngarkohet zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri, si dhe Drejtoria e Sekretarisë dhe e Komunikimit Qendror për njoftimin e tij.

5. Urdhri nr. 46, datë 31.1.2024, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë dhe delegimin e

kompetencave për zëvendësministrat për Evropën dhe Punët e Jashtme”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Igli Hasani

URDHËR**Nr. 912, datë 4.11.2024****PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM
KOMPETENCASH**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zëvendësministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural z. Arian Jaupllari nga data 5.11.2024 deri më datë 6.11.2024.

2. Në ushtrim të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri ushtron këto përgjegjësi kryesore:

a) trajton dhe nënshkruan përgjigjet zyrtare drejtuar institucioneve shtetërore, personave fizikë ose juridikë, publikë ose privatë, për të gjitha çështjet që janë brenda fushës së veprimtarisë të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe që lidhen me ushtrimin e funksionit të drejtimit administrativ të institucionit, përveç kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor;

b) ndjek dhe kontrollon veprimtarinë e nëpunësve të aparatit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe institucioneve të varësisë të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

c) bën ndarjen dhe mbikëqyr realizimin e detyrave nga nëpunësit e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në funksion të drejtimit dhe



administrimit të përditshëm të veprimtarisë të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

3. Në ushtrimin e kompetencave sipas këtij urdhri, zëvendësministri ndihmohet dhe mbështetet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ose personi që ushtron detyrat e tij në rast mungese.

4. Zëvendësministri ndalohet të nëndelegojë te një organ i tretë kompetencat e përfituara përmes këtij akti delegimi.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural z. Arian Jaupllari.

6. Ky urdhër hartohet në 3 (tri) kopje të njëjta, 1 (një) për arkiv-protokollin, 1 (një) për Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe 1 (një) për zëvendësministrin z. Arian Jaupllari.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 922, datë 28.10.2024

**PËR CAKTIMIN E FUSHËS SË
PËRGJEGJËSISË DHE DELEGIMIT TË
KOMPETENCAVE TË
ZËVENDËSMINISTRIT PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 22, 28, 29 dhe 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 3, 5 dhe pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000/2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; nenit 15, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 81/2022, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”,

URDHËROJ:

1. Znj. Silda Çepe, zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, gjatë ushtrimit të detyrës të ndjekë dhe të përgjigjet para ministrit për çështjet e mëposhtme:

a) ndjekjen e zbatimit të politikave për diasporën dhe koordinimin me institucionet e tjera përgjegjëse për këto politika;

b) koordinimin teknik, monitorimin dhe raportimin mbi ecurinë e zbatimit të angazhimeve të marra për çështjet e diasporës.

2. Zëvendësministri, përveç detyrave të përmendura në këtë urdhër, ndjek çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga ministri.

3. Zëvendësministri bashkëpunon dhe koordinon me zëvendësministrat e tjerë për çështje të caktuara, që ndërlidhen në fushën e përgjegjësisë së 2 (dy) ose më shumë zëvendësministrave.

4. Ngarkohet zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri, si dhe Drejtoria e Sekretarisë dhe e Komunikimit Qendror për njoftimin e tij.

5. Urdhri nr. 46, datë 31.1.2024, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë dhe delegimin e kompetencave për zëvendësministrat për Evropën dhe Punët e Jashtme”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Iglli Hasani

URDHËR
Nr. 923, datë 28.10.2024

**PËR CAKTIMIN E FUSHËS SË
PËRGJEGJËSISË DHE DELEGIMIT TË
KOMPETENCAVE TË
ZËVENDËSMINISTRIT PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neneve 22, 28, 29 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; neneve 3, 5 dhe pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; pikës 2, të



nenit 6, të ligjit nr. 9000/2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; nenit 15, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 81/2022, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”,

URDHËROJ:

1. Z. Endrit Yzeiraj, zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme gjatë ushtrimit të detyrës të ndjekë dhe të përgjigjet para ministrit për çështjet e mëposhtme:

a) përgatitjen dhe ndjekjen e zbatimit të platformës së diplomacisë ekonomike;

b) energjizimin e administratës publike.

2. Zëvendësministri, përveç detyrave të përmendura në këtë urdhër, ndjek çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga ministri.

3. Zëvendësministri bashkëpunon dhe koordinon me zëvendësministrat e tjerë për çështje të caktuara, që ndërliken në fushën e përgjegjësisë së 2 (dy) ose më shumë zëvendësministrave.

4. Ngarkohet zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri, si dhe Drejtoria e Sekretarisë dhe e Komunikimit Qendror për njoftimin e tij.

5. Urdhri nr. 46, datë 31.1.2024, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë dhe delegimin e kompetencave për zëvendësministrat për Evropën dhe Punët e Jashtme”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Igli Hasani

VENDIM Nr. 67, datë 3.10.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 3.10.2024, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 7 (Sh) 2024 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Shoqëria “Prodhim Veshje nr. 2” sh.a., përfaqësuar nga Elisabeta Dosti.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Arta Mici, përfaqësuar nga avokat Gramoz Çela, me prokurë.

Shoqëria “Archimed International Investitor” sh.p.k., përfaqësuar nga avokat Gramoz Çela, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 8223, datë 29.9.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 185, datë 5.2.2010, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2011-277, datë 25.3.2011, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 18, pika 1, 31, shkronjat “b” dhe “ç”, 33, pika 1, 41, pika 1, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).



GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuases, shoqërisë “Prodhim Veshje nr. 2” sh.a., e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Arta Micit dhe shoqërisë “Archimed International Investor” sh.p.k., të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësja, shoqëria “Prodhim Veshje nr. 2” sh.a., ka në pronësi ndërtesa dhe truall me sipërfaqe totale 8.933,5 m², të cilat kanë qenë pjesë e ish-Ndërmarrjes së Prodhim Veshjeve (*ish-NPV*), Tiranë, të privatizuara në kohë të ndryshme. Gjatë procesit të privatizimit një prej ndërtesave (ish-reparti i të imtave) është përjashtuar nga përfshirja në kapitalin e ish-NPV-së, Tiranë dhe nëpërmjet ankandit të datës 13.9.1996 është shitur te shtetasi A.H. Me kontratën e dhurimit të datës 14.2.1997 ky shtetas e ka dhuruar këtë pronë te subjekti i interesuar Arta Mici, e cila rezulton pronare e ndërtesës dhe truallit 550 m².

2. Në truallin në pronësi të subjektit të interesuar Arta Mici, shoqëria “Archimed International Investor” sh.p.k. ka filluar ndërtimin e një ndërtese. Me pretendimin se trualli mbi të cilin po realizohej punimi nuk i është shitur asnjëherë subjektit të interesuar, kërkuësja, më datë 22.11.2007, ka paraqitur kërkesëpadi me objekt kallëzimin e një punimi të ri, detyrimin e palës së paditur të ndalojë ndërtimin, shembjen e punimit dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga prishja e murit rrethues, si dhe marrjen e masës së sigurimit të padisë.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 11786, datë 4.12.2007 “Për sigurimin e padisë”, ka vendosur marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke urdhëruar ndalimin e punimeve nga subjekti i interesuar. Kjo gjykatë, me vendimin nr. 2258, datë 11.12.2007, ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit të vendimit nr. 11786, datë 4.12.2007 “Për sigurimin e padisë” dhe ka filluar procedurat për ekzekutimin e tij. Me vendimin nr. 146, datë 20.6.2008, Gjykata e Apelit Tiranë ka lënë në fuqi

vendimin nr. 11786, datë 4.12.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe më pas Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2009-135, datë 26.9.2009, ka vendosur mospranimin e rekursit të subjektit të interesuar.

4. Kundër veprimeve përmbarimore për ekzekutimin e vendimit të sigurimit të padisë, subjektet e interesuara, më datë 11.1.2008, kanë paraqitur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me vendimin nr. 4369, datë 14.5.2008, ka vendosur rrëzimin e padisë. Mbi ankimin e tyre, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1483, datë 11.11.2009, ka vendosur pranimin e padisë me objekt anulimin e veprimeve përmbarimore.

5. Për gjykimin e themelit të kërkesëpadiës, me vendimin nr. 8223, datë 29.9.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë me objekt: “Kallëzim i punimit të ri”, si të pambështetur në prova dhe në ligj, duke hequr edhe masën e sigurimit të padisë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuësja. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 185, datë 5.2.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 8223, datë 29.9.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me vendimin nr. 00-2011-277, datë 25.3.2011, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuases, pasi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC) (*i kohës së shqyrtimit të rekursit*).

7. Më datë 14.2.2013 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual. Me vendimin nr. 44, datë 31.10.2013 (*vendimi nr. 44/2013*) Gjykata ka vendosur refuzimin e kërkesës, për shkak se nuk arriti shumicën e të gjithë anëtarëve të saj për vendimmarrje sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000 në fuqi në kohën e gjykimit të kësaj çështjeje.

8. Më datë 29.4.2014, kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) (*aplikimi nr. 34649/14 Prodhim Veshje nr. 2 sh.a. kundër Shqipërisë*), duke pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit nga Gjykata, për shkak të mosformimit të kuorumit të vendimmarrjes, mungesën e paanshmërisë së gjyqtarëve në gjykatën e apelit dhe mungesën e arsytimit të vendimit të Gjykatës së Lartë bazuar në nenin 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së. GJEDNJ-ja, me vendimin e datës



17.10.2023 ka konstatuar se ka pasur shkelje të nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së lidhur me të drejtën e aksesit në Gjykatë; konstatimi i shkeljes përbën në vetvete shpërblim mjaftueshëm të drejtë për dëmin jomonetar dhe shteti i paditur ka detyrimin të dëmshpërblejë kërkuuesen për kostot dhe shpenzimet. Gjithashtu, GJEDNJ-ja në arsyetimin e vendimit të saj është shprehur edhe për dy pretendimet e tjera, përkatësisht për të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, duke vlerësuar se kërkuësja nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion, pasi nuk ka paraqitur kërkesë për dorëheqjen e anëtarëve të trupit gjykues në gjykatën e apelit, mundësi kjo e parashikuar nga legjislacioni procedural civil. Ndërsa për sa i përket pretendimit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se ai është haptazi i pabazuar, me argumentin se kur Gjykata e Lartë refuzon të pranojë një çështje për faktin se arsyet ligjore nuk janë të mbështetura, arsyetimi shumë i kufizuar mund të plotësojë kriteret e nenit 6 të KEDNJ-së.

9. Pas vendimit të GJEDNJ-së, më datë 2.2.2024, kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për rihapjen e procesit të përfunduar me vendimin nr. 44/2013 të Gjykatës, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore sipas objektit të saj, e cila, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar më datë 16.2.2024. Kolegji i Gjykatës më datë 18.4.2024 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila më datë 7.5.2024 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi objekt kundërshtimi i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

10.1 *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi trupi gjykues i cili ka disponuar për themelin e kërkesëpadisë me vendimin nr. 185, datë 5.2.2010, në Gjykatën e Apelit Tiranë është i njëjti me atë që ka disponuar më parë për kërkesën për anulimin e veprimeve përmbartimore që lidheshin me vendosjen e masës së sigurimit të padisë me vendimin nr. 1483, datë 11.11.2009 të kësaj gjykate.

Në këtë të fundit trupi gjykues ka deklaruar se kërkuësja e ka humbur gjyqin e themelit dhe subjekti i interesuar është pronar i truallit. Ndonëse kërkuësja i ka kërkuar trupit gjykues heqjen dorë nga gjykimi i çështjes së themelit, kjo kërkesë nuk është pasqyruar në procesverbalin e seancës gjyqësore. Anëtarët e trupit gjykues kishin detyrimin ligjor për të dhënë dorëheqjen nga gjykimi i çështjes. Ky pretendim është ngritur edhe në rekursin përpara Gjykatës së Lartë.

10.2 *Standardit të arsyetimit të vendimit të lidhur me të drejtën e aksesit*, pasi vendimi i gjykatës së shkallës së parë është kontradiktor, për shkak se, nga njëra anë, konstaton se kërkuësja nuk legjitimohet për ngritjen e padisë dhe, nga ana tjetër, shprehet se padia është parashkruar, argumente të cilat në dukje përjashtojnë njëri-tjetrin. Në këtë mënyrë, kërkuësja i është mohuar e drejta për të marrë një përgjigje përfundimtare lidhur me pretendimet e ngritura. Ky standard është cenuar edhe në Gjykatën e Lartë, pasi vendimi i saj përmban një arsyetim *de plano*, duke përmendur vetëm dispozitën ligjore. Ndonëse në rekurs është ngritur një pretendim me natyrë kushtetuese, si ai për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykatën e apelit, Gjykata e Lartë nuk e ka marrë atë në shqyrtim.

10.3 *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi gjatë gjykimit në shkallën e parë kërkuësja ka kërkuar thirrjen në cilësinë e personit të tretë të shitësit (Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike – ish-AKP-së); thirrjen e një eksperti të pavarur për shkak të dy ekspertimeve kontradiktore për pronën; detyrimin e gjykatës për të kërkuar pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurisë të Paluajtshme, Tiranë (ZVRPP, Tiranë) dokumentacionin që lidhej me procedurën e fshirjes së pronës të palës së paditur. Këto kërkesa nuk janë pranuar nga gjykata e shkallës së parë.

11. **Subjektet e interesuara**, Arta Mici dhe shoqëria “Archimed International Investor” sh.p.k., në mënyrë të përmbledhur, kanë prapësuar si vijon:

11.1 Pretendimi për cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme* është i pabazuar, pasi kërkuësja nuk ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues në gjykatën e apelit. Në dosjen gjyqësore nuk gjendet e administruar as kopja e vendimit nr. 1483, datë 11.11.2009, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Referuar procesverbalit të datës 5.2.2010 në këtë gjykatë, kërkuësja është shprehur



dakord me trupin gjykues. Gjithashtu kërkesja nuk ka paraqitur as regjistrimin audio të seancës gjyqësore për të mbështetur pretendimin e saj. Për më tepër, edhe vetë kërkesja e ka pranuar se nuk ka paraqitur kërkesë për përjashtim, e cila është një mjet procedural me afat dhe në rast se nuk ushtrohet nga palët bie në dekadencë. Po kështu, anëtarët e trupit gjykues nuk mund të paraqisnin dorëheqjen e tyre, për sa kohë nuk kishte një kërkesë nga pala paditëse. Procesi gjyqësor për të cilin kërkesja pretendon cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme është një gjykim procedural për masën e sigurimit të padisë dhe jo një gjykim themeli, pra nuk përbën paragjykim për zgjidhjen e çështjes.

11.2 Pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit* është i pabazuar, pasi argumentet e dhëna nga gjykata nuk përjashtojnë njëra-tjetrën, por e kanë ndihmuar atë për të arritur një konkluzion të drejtë dhe logjik. Të dyja gjykatat më të ulëta i kanë analizuar faktet dhe rrethanat e çështjes, kanë marrë në shqyrtim pretendimet e palëve dhe përfundimet e tyre janë koherente e nuk përmbajnë kontradiksione. Dhënia e disa argumenteve më tepër për mospranimin e padisë nuk e bën vendimin alogjik.

11.3 Për sa i përket pretendimit për cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, gjykatat nuk mund të pranenin kërkesën për thirrjen në gjykim të ish-AKP-së, pasi ky organ nuk ka asnjë element lidhës me palët në konflikt. Ky subjekt çështjen e kallëzimit të një punimi të ri nuk e ka të përbashkët me kërkesën dhe nuk mund të detyrohet të japë ndonjë garanci ose shpërblim në rast të rrëzimit të padisë. Njoftimi i një personi të tretë është në diskrecion të gjykatës dhe nisur nga fakti se pronat janë zhvilluar e tjetërsuar në subjekte të ndryshme, shteti nuk ka asnjë interes të ligjshëm për to. Edhe pretendimi për thirrjen e ekspertit është i pabazuar, pasi secila palë në konflikt zotëron titujt e pronësisë, të cilat nuk krijojnë mbivendosje dhe kundërshtimi i tyre nuk përbën shkakun dhe objektin e padisë së kallëzimit të një punimi të ri. Po kështu, i pabazuar është edhe pretendimi për të kërkuar përgjigje nga kryeregjistruesi, pasi ankimi i paraqitur nga kërkesja në ZVRPP-në, Tiranë nuk i përket këtij gjykimi, ndonëse vendimi i këtij organi është administruar nga gjykata e apelit.

III

Procesi në Gjykatën Kushtetuese

A. Për kërkesën për rihapjen e procesit

12. Gjikata vëren se, referuar nenit 71/c, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 8577/2000, nëse ajo ka vendosur më parë për një çështje, e cila është gjykuar nga një gjykatë ndërkombëtare dhe kjo e fundit ka konstatuar se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individit, si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës, subjekti i cenuar, në favor të të cilit ka vendosur gjykata ndërkombëtare, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për rihapjen e procesit gjyqësor, e cila paraqitet brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e vendimit të gjykatës ndërkombëtare. Kërkesa duhet të përmbajë një përmbledhje të vendimit të gjykatës ndërkombëtare me çështjet kryesore që ka konstatuar ajo gjykatë, kërkimet konkrete dhe kërkesi duhet të kërkojë shprehimisht rihapjen e procesit, si dhe shfuqizimin e aktit.

13. Bazuar në sa më lart, Gjikata paraprakisht vlerëson nëse në rastin në shqyrtim janë plotësuar kriteret ligjore të parashikuara në nenin 71/c të ligjit nr. 8577/2000. Konkretisht, Gjikata çmon se kërkesja legjitimohet *ratione personae* për paraqitjen e kërkesës për rihapjen e procesit, pasi ka qenë palë në procesin kushtetues, vendimin e të cilit e ka ankimuar për të cilin është zhvilluar një proces në GJEDNJ. Kjo e fundit, pasi ka konstatuar shkeljen e nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së të lidhur me të drejtën e aksesit në Gjykatë, ka vlerësuar se nisur nga natyra e ankimit të kërkeses dhe shkeljes së konstatuar, forma më e përshtatshme e korrigjimit në këtë çështje do të ishte rihapja e procesit përpara Gjykatës, bazuar në faktin se ajo është në gjendje të sigurojë *restitutio in integrum*.

14. Për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, në rastin e kërkesave për rihapjen e procesit, llogaritja e afatit ligjor 4-mujor fillon nga hyrja në fuqi e vendimit të gjykatës ndërkombëtare, pra nga botimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 71 shkronja “c”, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000. Gjikata vërejt se vendimi i GJEDNJ-së për çështjen “Prodhim Veshje nr. 2 sh.a. kundër Shqipërisë” është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 171, datë 22.11.2023 dhe kërkesja i është drejtuar asaj më datë 2.2.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71, shkronja “c”, pika 4, i ligjit nr. 8577/2000. Për rrjedhojë, kërkesja e përmbush edhe kriterin *ratione temporis*.



15. Për këto arsye, me vendimin e ndërmjetëm të datës 3.10.2024, Gjykata ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 44/2013 të saj dhe pranimin e kërkesës për rihapjen e procesit. Për rrjedhojë, Gjykata do të vijojë me shqyrtimin e ankimit kushtetues individual të kërkuës në të njëjtën fazë të procesit në të cilën ka përfunduar gjykimi kushtetues i mëparshëm. Ky i fundit sikurse u përmend edhe më sipër (*shih paragrafin 7 të vendimit*), është përmbyllur me vendim refuzimi, për shkak se gjatë shqyrtimit të pretendimeve nuk u arrit shumica e të gjithë anëtarëve të saj për vendimmarrje. Për këtë arsye, në vendimin e mëparshëm të Gjykatës nuk është analizuar çështja e legjitimitetit të kërkuës dhe as themeli i pretendimeve të saj. Prandaj, nisur nga detyrimi që lind nga vendimi i GJEDNJ-së, në vijim Gjykata do të analizojë secilin nga pretendimet e parashtruara nga kërkuësja në kërkesën fillestare drejtuar asaj, si në kuptim të legjitimitetit të saj për vënien në lëvizje të Gjykatës, ashtu edhe në lidhje me bazueshmërinë e tyre në themel.

IV

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitetin e kërkuës

16. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

17. Gjykata vlerëson se çështja e legjitimitetit *ratione personae* dhe *ratione temporis* të kërkuës është konsideruar e përmbushur që në vendimin e mëparshëm të saj, ndaj ajo nuk do të ndalet më tej në analizën e këtyre kriterëve.

18. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se sipas nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individit pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individit t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 14, datë 21.6.2022; nr. 8, datë 19.3.2018; nr. 31, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata vëren se kërkuësja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, standardit të arsyetimit të vendimit të lidhur me të drejtën e aksesit, të cilat janë ngritur edhe në aplikimin e saj drejtuar GJEDNJ-së, si dhe të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit.

20. Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, Gjykata vëren se kërkuësja ka pretenduar se trupi gjyqësor i cili ka disponuar për themelin e kërkesëpadisë me vendimin nr. 185, datë 5.2.2010 në Gjykatën e Apelit Tiranë është i njëjti me atë që ka disponuar më parë për kërkesën për anulimin e veprimeve përmbarimore që lidheshin me vendosjen e masës së sigurimit të padisë me vendimin nr. 1483, datë 11.11.2009, të kësaj gjykate. Në këtë të fundit trupi gjyqësor ka deklaruar se kërkuësja e ka humbur gjyqin e themelit dhe subjekti i interesuar është pronar i truallit. Ndonëse kërkuësja nuk ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e trupit gjyqësor, i ka kërkuar atij gjatë procesit të heqë dorë nga gjykimi i çështjes së themelit, kërkesë e cila nuk është pasqyruar në procesverbalin e seancës gjyqësore. Sipas saj, anëtarët e trupit gjyqësor kishin detyrimin ligjor për të dhënë dorëheqjen nga gjykimi i çështjes. Ky pretendim është ngritur edhe në rekursin përpara Gjykatës së Lartë.

21. Subjektet e interesuara, Arta Mici dhe shoqëria “Archimed International Investitor” sh.p.k., kanë prapësuar se ky pretendim është i pabazuar, pasi kërkuësja nuk ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjyqësor në



gjykatën e apelit. Për më tepër, në dosjen gjyqësore nuk gjendet e administruar as kopja e vendimit nr. 1483, datë 11.11.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Referuar procesverbalit të datës 5.2.2010 në këtë gjykatë kërkesja është shprehur dakord me trupin gjykues. Gjithashtu kërkesja nuk ka paraqitur as regjistrimin audio të seancës gjyqësore për të mbështetur pretendimin e saj. Sipas subjekteve të interesuara, edhe vetë kërkesja e ka pranuar se nuk ka paraqitur kërkesë për përjashtim, e cila është një mjet procedural me afat dhe në rast se nuk ushtrohet nga palët, bie në dekadencë. Po kështu, sipas subjektit të interesuar, anëtarët e trupit gjykues nuk mund të paraqisnin dorëheqjen e tyre, për sa kohë nuk kishte një kërkesë nga pala paditëse. Procesi gjyqësor për të cilin kërkesja pretendon cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme është një gjykim procedural për masën e sigurimit të padisë dhe jo një gjykim themeli, pra nuk përbën paragjykim për zgjidhjen e çështjes.

22. Gjykata evidenton se kërkesja ka pranuar se nuk ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarëve, por i ka kërkuar trupit gjykues të heqë dorë nga shqyrtimi i çështjes, duke depozituar edhe vendimin nr. 1483, datë 11.11.2009, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Sipas kërkuarës, kjo kërkesë nuk është pasqyruar në procesverbalin e seancës gjyqësore. Nga përmbajtja e dosjes gjyqësore të administruar për efekte të këtij gjykimi, nuk rezulton një kërkesë me shkrim drejtuar gjykatës së apelit, ndërsa nga procesverbali i seancës së datës 5.2.2010 rezulton se palët janë shprehur dakord me gjykatën dhe nuk kanë pasur kërkesa paraprake.

23. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vëren se GJEDNJ-ja ka evidentuar se kërkesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, pasi nuk ka paraqitur kërkesë për dorëheqjen e anëtarëve të trupit gjykues në gjykatën e apelit, mundësi kjo e parashikuar shprehimisht në nenet 72 dhe 74 të KPC-së. Sipas kësaj gjykate, për sa kohë shoqëria kërkuarë nuk ka përdorur procedurën standarde të paraqitjes së kësaj kërkesë, të cilën ajo e ka pranuar shprehimisht, ky pretendim refuzohet, sipas nenit 35, paragrafët 1 dhe 4, të KEDNJ-së për mosshkrimin e mjeteve të brendshme juridike (*shih paragrafin 17 të vendimit të GJEDNJ-së*).

24. Në këto kushte, Gjykata, bazuar edhe në vlerësimin e GJEDNJ-së lidhur me këtë pretendim, vlerëson se kërkesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika

1, shkronja “P”, të Kushtetutës, për rrjedhojë pretendimi i saj për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme nuk mund të merret në shqyrtim.

25. Po kështu, Gjykata vëren se kërkesja ka pretenduar edhe cenimin e standardit të arsyetimit të lidhur me të drejtën e aksesit për dy shkaqe. *Së pari*, vendimi i gjykatës së shkallës së parë është kontradiktor, pasi, nga njëra anë, konstaton se kërkesja nuk legjitimohet për ngritjen e padisë dhe, nga ana tjetër, shprehet se padia është parashikuar, argumente të cilat në dukje përjashtojnë njëri-tjetrin, duke i mohuar kërkuarës të drejtën për të marrë një përgjigje përfundimtare lidhur me pretendimet e ngritura. *Së dyti*, ky standard është cenuar edhe nga Gjykata e Lartë, pasi vendimi i saj përmban një arsyetim *de plano*, duke përmendur vetëm dispozitën ligjore.

26. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se argumentet e dhëna nga gjykata nuk përjashtojnë njëra-tjetrën, por e kanë ndihmuar atë për të arritur një konkluzion të drejtë dhe logjik. Të dyja gjykatat e faktit i kanë analizuar faktet dhe rrethanat e çështjes, kanë marrë në shqyrtim pretendimet e palëve dhe përfundimet e tyre janë koherente e nuk përmbajnë kontradiksione. Sipas tyre, dhënia e disa argumenteve më tepër për mospranimin e padisë nuk e bën vendimin alogjik.

27. Gjykata konstaton se për sa i përket shkakut të parë lidhur me kontradiktoritetin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, kërkesja e ka parashtruar atë drejtpërdrejt dhe për herë të parë në ankimin kushtetues individual, rrjedhimisht ajo nuk i ka shteruar mjetet juridike efektive përpara se t'i drejtohej Gjykatës, ndaj edhe ky shkak nuk mund të merret në shqyrtim. Ndërsa për sa i përket shkakut të dytë që lidhet me vendimin e Gjykatës së Lartë, kërkesja nuk ka më mjete të tjera në dispozicion për ta kundërshtuar atë përveç ankimit kushtetues individual. Gjithashtu, ajo ka shteruar mjetet juridike efektive edhe në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit.

28. Bazuar në sa më sipër, në kuptim të legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata do të analizojë në vijim pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Lartë dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, të cilat janë me natyrë kushtetuese dhe, si të tilla, hyjnë në juridiksionin e saj.

*B. Për themelin e pretendimeve**B.1 Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit*

29. Kërkuesja ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë cenon standardin e arsytimit të vendimit, pasi përmban një arsyetim *de plano*, duke përmendur vetëm dispozitën ligjore që është zbatuar.

30. Subjekti i interesuar, Arta Mici, ka prapësuar se procesi në tërësi ka qenë i rregullt dhe vendimet gjyqësore kanë përmbushur kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për standardin e arsytimit të vendimit.

31. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 3, datë 20.1.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u takon vendimeve të mospranimit të rekursit, në jurisprudencë konstante është pranuar se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegeve të Gjykatës së Lartë gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 21, datë 16.4.2015; nr. 37, datë 19.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Nga rrethanat e çështjes në shqyrtim, rezulton se kërkuesja ka nisur një proces gjyqësor me objekt kallëzimin e një punimi të ri, duke detyruar subjektet e interesuara të ndalonin ndërtimin dhe të shembnin punimin e filluar në pronën e saj. Gjykatat e faktit kanë pranuar se kërkuesja nuk legjitimohej në ngritjen e kësaj padie, sepse ajo nuk është pronare ose poseduese e sendit tokë truall mbi të cilin po realizohej ndërtimi dhe as ka cilësinë e ndonjë subjekti tjetër që me ligj gëzon të drejta reale për pasurinë. Fakti se prona mbi të cilën po realizohej ndërtimi ishte në pronësi të kërkueses nuk u arrit të provohej në gjykim, pasi ajo pasuri nuk ka qenë asnjëherë kapital i shoqërisë. Për këto shkaqe gjykatat kanë vendosur rrëzimin e padisë, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se rekursi i paraqitur nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga KPC-ja, duke vendosur mospranimin e tij.

33. Gjykata vëren se në vendimin e Gjykatës së Lartë është pasqyruar vendimmarrja e gjykatave më të ulëta, shkaqet e ngritura në rekurs, si dhe ligji i zbatueshëm, ndërsa në pjesën arsyetuese ajo gjykatë, pasi ka konstatuar se rekursi nuk përmbante shkaqe nga ato që parashikonte neni 472 i KPC-së (*i kohës së shqyrtimit të rekursit*), ka vendosur mospranimin e tij. Në tërësinë e tij vendimi paraqitet i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Përmes parashtrimit të shkaqeve të rekursit në vendimin gjyqësor të kundërshtuar, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë tregon se pasi i ka vlerësuar ato, ka arritur në përfundimin se rekursi i paraqitur nga kërkuesja është haptazi i pabazuar.

34. Gjithashtu, Gjykata konstaton se GJEDNJ-ja në vendimin për çështjen e kërkueses ka vlerësuar se ndonëse Gjykata e Lartë kishte arsyetuar në mënyrë të kufizuar *de plano*, në mënyrë të nënkuptuar ajo ka treguar që kërkuesja nuk kishte ngritur ndonjë nga çështjet e ligjit të parashikuara në dispozitat e brendshme përkatëse. GJEDNJ-ja ka pohuar se kur Gjykata e Lartë refuzon të pranojë një çështje për faktin se arsyet ligjore nuk janë të mbështetura, arsyetimi shumë i kufizuar mund të plotësojë kriteret e nenit 6 të KEDNJ-së (*shih paragrafin 19 të vendimit të GJEDNJ-së*).

35. Për sa më lart, Gjykata, bazuar edhe në qëndrimin e GJEDNJ-së në këtë rast, çmon se arsyetimi i kufizuar i vendimit të Gjykatës së Lartë është në përputhje me standardet e Gjykatës për këto lloj vendimesh, duke përmbushur kriteret në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor. Prandaj, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit është i pabazuar.

B.2 Për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit

36. Kërkuesja ka pretenduar se ndonëse në gjykimin në shkallën e parë ajo ka kërkuar thirrjen në cilësinë e personit të tretë të shitësit (Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike–ish-AKP-së); thirrjen e një eksperti të pavarur për shkak të dy ekspertimeve kontradiktore për pronën; detyrimin e gjykatës për të kërkuar pranë ZVRPP-së, Tiranë dokumentacionin që lidhet me procedurën e fshirjes së pronës së palës së paditur, këto kërkesa nuk janë pranuar nga gjykata e shkallës së parë.

37. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se gjykatat nuk mund të pranenin kërkesën për thirrjen



në gjykim të ish-AKP-së, pasi ky organ nuk ka asnjë element lidhës me palët në konflikt. Ky subjekt çështjen e kallëzimit të një punimi të ri nuk e ka të përbashkët me kërkuesen dhe nuk mund të detyrohet të japë garanci ose shpërblim në rast të rrëzimit të padisë. Njoftimi i një personi të tretë është në diskrecion të gjykatës dhe nisur nga fakti se pronat janë zhvilluar e tjetërsuar në subjekte të ndryshme, shteti nuk ka asnjë interes të ligjshëm për to. Edhe pretendimi për thirrjen e ekspertit është i pabazuar, pasi secila palë në konflikt zotëron titujt e pronësisë, të cilat nuk krijojnë mbivendosje dhe kundërshtimi i tyre nuk përbën shkakun dhe objektin e padisë së kallëzimit të një punimi të ri. Po kështu, i pabazuar është edhe pretendimi për të kërkuar përgjigje nga kryeregjistruesi, pasi ankimi i paraqitur nga kërkuesja në ZVRPP-në, Tiranë nuk i përket këtij gjykimi, ndonëse vendimi i këtij organi është administruar nga gjykata e apelit.

38. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes tyre. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe, më pas, gjyqtari gjatë gjykimit, t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte parimi i barazisë së armëve, atëherë argumentet e njëres palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar, për rrjedhojë e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, Gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet 13, datë 21.3.2023; nr. 41, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë thirrjen si person të tretë të Drejtorisë së

Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike, si subjekti që kishte realizuar shitjen e pasurisë. Me vendim të ndërmjetëm kjo gjykatë e ka rrëzuar këtë kërkesë, me arsyetimin se i gjithë dokumentacioni që i përket privatizimit të ish-NPV-së i është paraqitur gjykatës dhe është administruar në cilësinë e provës së bashku me dokumentacionin përkatës. Për rrjedhojë, thirrja si palë nuk do t'i shërbente gjykimit të kësaj çështjeje civile, pasi ajo nuk tërhiqte asnjë interes të ligjshëm. Gjithashtu, gjatë gjykimit është kërkuar edhe thirrja e një eksperti, kërkesë të cilën gjykata e ka konsideruar të pabazuar në ligj, për sa kohë kërkuesja nuk arriti të paraqiste asnjë provë lidhur me dëmin e shkaktuar nga subjekti i interesuar dhe nuk ndodhej përpara një çështjeje fakti, por ai përbente një pretendim ligjor të paprovuar. Po kështu, kërkuesja ka kërkuar nga gjykata për t'iu drejtuar me shkresë zyrtare ZVRPP-së, Tiranë lidhur me procedurën e fshirjes së pronës të subjektit të interesuar. Për këtë pretendim gjykata ka arsyetuar se ndodhej përpara një padie me objekt kallëzimin e një punimi të ri dhe jo përpara një gjykimi administrativ të parashikuar në dispozita të posaçme procedurale dhe materiale, siç është procedura e fshirjes nga regjistrat të një pasurie të kryer nga kryeregjistruesi. Për më tepër, ZVRPP-ja, Tiranë i ka kthyer përgjigje gjykatës se nuk mund të vazhdonte me shqyrtimin e kërkesës për fshirjen e regjistrimit të pasurisë për sa kohë palët ndodheshin në një proces gjyqësor (*shih faqet 16–18 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*).

40. Gjykata vëren se këto pretendime të kërkueses janë ngritur edhe në ankimin e paraqitur në gjykatën e apelit, e cila e ka gjetur të drejtë arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe në vijim, në rekursin në Gjykatën e Lartë, e cila ka vlerësuar se rekursi nuk përmbante asnjë nga shkaqet që parashikon neni 472 i KPC-së (i kohës së shqyrtimit të rekursit).

41. Në këndvështrim të sa më lart, Gjykata konstaton se kërkesat paraprake të kërkueses për thirrjen e palëve të treta në gjykim ose ekspertit janë marrë në shqyrtim nga gjykatat, duke iu dhënë përgjigje të argumentuar. Në analizë të vendimmarrjes së gjykatave të faktit rezulton se kërkueses i është dhënë mundësia të paraqesë argumente dhe prova në mbështetje të pretendimeve të saj, si dhe të kundërshtojë prapësimet e palës tjetër. Gjithashtu, gjykatat kanë analizuar faktet dhe provat e paraqitura në gjykim



përkundrejt atyre të paraqitura nga subjekti i interesuar. Në këtë kuptim, kërkesja nuk rezulton të jetë vënë në kushte të pabarabarta me palët e tjera në proces. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit nuk është i bazuar.

42. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuases janë të pabazuara, sipas arsytimit të mësipërm, ndaj kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71/c dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 3.10.2024.

Shpallur, më 5.11.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari,
Genti Ibrahimi, Ilir Toska, Sandër Beci, Fiona
Papajorgji, Marjana Semini

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 144 lekë